



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit*

*Lokal-Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*

*Ministry of Local Government Administration*

**UDHËZUES PËR APLIKANTË**

**FONDI I MAPL-së PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL 2014**

**PRISHTINË**

**Shkurt 2014**

UDHËZUESI PËR APLIKANTË, NGA FONDI I MAPL-së PËR ZHVILLIM  
EKONOMIK RAJONAL 2014

**HYRJE**

Grandi për Zhvillimi Rajonal është bashkëfinancim i MAPL për programin EURED (European Union Regional Economic Development) i cili ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e kushteve për zhvillimin e ekonomik rajonal të qëndrueshëm në të gjitha rajonet ekonomike të Kosovës dhe për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, mjedisor dhe kulturor.

Shuma e Fondit për Zhvillim Rajonal;

Shuma e fondit për vitin 2014 do të jete 900.000,00 euro.

**Objektivi i përgjithshëm**

Objektivi i përgjithshëm i Fondit është të mbështesë rigjenerimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonet ekonomike.

**Rezultatet Specifike**

Krijimi i këtij fondi do t'i mundësoj komunave për të zhvilluar më tej rolin e tyre udhëheqës në përmirësimin e zhvillimit ekonomik përmes një projekti që kontribuon në një apo më shumë prioritetet të listuara në Strategjinë e tyre për Zhvillimit Rajonal.

**Llojet e aktiviteteve**

Projektet do të kategorizohen si investime kapitale, të ndërlidhura me objektivin e përgjithshëm të fondit.

**Vlera e projekteve që aplikojnë komunat**

Kërkesat për financim duhet të jenë prej 50,000.00 deri 180,000.00 euro. Të gjitha shpenzimet e propozuara të buxhetit duhet të jenë të pranueshme sipas LMFPP

(Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë) të Kosovës dhe Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës (LPPK) që duhet të zbatohet gjatë gjithë kohës.

### **Kriteret e Pranueshme**

Vetëm komunat janë të lejueshme të aplikojnë për fonde. Aplikantët tjerë, potencial-Këshillat e komuniteteve, OJQ, Asociacionet e ndryshme etj. duhet t'i kanalizojnë kërkesat e tyre përmes komunës.

1. Komuna duhet të propozoj projektin që është në pajtueshmëri me objektivin e përgjithshëm të fondit
2. Një projekt ideor, dhe vlerësimi paraprak i kostos duhet të përgatitet nga komunat. Projekt ideor duhet të jetë në pajtueshmëri me normat ekzistuese dhe standardet e aplikueshme në Kosovë.
3. Projektin ideor duhet të hartohet në harmoni me standardet e vlerësimit të ndikimit në mjedis (aty ku është e aplikueshme) të aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor.
4. Projektin duhet të jetë projekt i ri dhe jo vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër;
5. Projektin duhet të përfundojë brenda vitit 2014.

Si të aplikoni;

Ky udhëzues dhe format për aplikim janë të vendosura në ueb-faqen e MAPL-së ose në Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal. Pyetjet në formularin e aplikimit duhet të plotësohen sa më shumë që të jetë e mundur. Të gjitha pyetjet në formular janë të rëndësishme për aplikantët mirëpo kërkohet vëmendje e veçantë më sa vijon:

- Qëllimi i përgjithshëm dhe objektivat e projektit;
- Pse është i nevojshëm projekti;
- Partneriteti në mes të komunave është i obligueshëm, roli, përfshirja dhe kontributi i partnerit (ve) duhet të jenë të definuar mirë;
- Cilat janë rezultatet e drejtpërdrejta të projektit;
- A mundet projekti të përfundojë me kohë dhe
- Qëndrueshmëria e projektit.

Komunat për përgatitjen e projekteve të rëndësishme duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë nevojës për të siguruar vlerësimin e plotë të kostos, planit të punës, autorizimeve dhe punëve të tjera përgatitore, të jenë të përfunduara para parashtrimit të kërkesës.

Nëse një komunë ka miratimin ose bashkëpunimin për projektet e tyre me ministritë përkatëse, të dhënat duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Një bashkëpunim i tillë është shpesh i nevojshëm për projektet lidhur me turizmin, bujqësinë, mjedisin dhe infrastrukturën tjetër komunale.

Formulari i aplikimit është në aneksin (i) dhe duhet të plotësohet në mënyrë elektronike. Ai duhet të dorëzohet në MAPL deri 14 mars 2014, në formën e printuar të kërkesës origjinale, të nënshkruar nga kryetari.

### **Vlerësimi i projektit**

Komisioni i vlerësimit do të jetë nga stafi i MAPL-së. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimit mund të kërkojë nga ministritë/komunat përkatëse informata shtese për një projekt propozim specifik.

Vlerësimi i projekteve do të jetë objektiv dhe transparent dhe do të bazohet në përgjegjësit, që në fakt ka qenë e shkruar në formularin e aplikimit. Prandaj, komunat duhet të përgjigjen në çdo pyetje duke dhënë sa më shumë informacione që të jetë e mundur, si dhe dokumentacion relevant.

Aplikuesit për fond, duhet t'i bindin vlerësuesit se projekti i propozuar i përmbush të gjitha objektivat e parapara me këtë dokument. Vetëm ato projekt-propozime që arrijnë një rezultat minimal prej 50% të pikëve do të kualifikohen. Formulari i aplikimit ofron pikët maksimale për secilën pyetje, andaj, përgjigjja jo adekuate në pyetjet e parashtruara nuk do të vlerësohet me pikë maksimale, për këtë arsye nëse kërkesa nuk kalon 50% e pikëve do të refuzohet.

Kjo ka për qëllim që çdo rajoni ekonomik t'i ofrohet një shume për financim, por nuk do të thotë se është e domosdoshme që të jete përfitues nëse nuk ka aplikacion të mirë. Ne rastin kur kemi aplikime jo cilësore nga një rajon (rajone) i veçantë (ta), bilanci i pashpenzuar do të ndahet për projekte të tjera të vlerësuara. MAPL-ja do të

krijohet një listë rezervë të projekteve që kanë kaluar fazat e vlerësimit, por nuk kanë arritur të miratohen ngase nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për miratimin. Nëse fondet vihen në dispozicion (p.sh. nëpërmjet projekteve të miratuara mirëpo që kanë dështuar të pajtohen me Marrëveshjen e Mirëkuptimit), atëherë komisioni i vlerësimit do të përzgjedh projektin e ardhshëm për miratim.

### **Aplikacionet e suksesshme**

Komunat me aplikime të suksesshme, do të jenë të informuara se projektet e tyre janë miratuar dhe do të ju ofrohen Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MM) të cilat do të hartohen nga MAPL-ja. Pasi që të nënshkruhet MM në mes të palëve nënshkruese, MAPL apo komuna varësisht nga MM do të fillojë me procedurat për implementimin e projekteve.

### **Aplikacionet e pa-suksesshme**

Për projektet që nuk e kalojnë pragun e pikëve prej 50% komunat do të informohen nga MAPL.

### **Kushtet e pranueshmërisë**

Ky fond do të jetë i hapur për aplikime nga partneritetet e komunave. Çdo komunë mund të paraqes vetëm një aplikacion si lider, dhe një aplikacion si partner me komuna tjera. Komunat inkurajohen për të zhvilluar projekte që mbështesin aktivitetet për bashkëpunim ndër-komunal. Aplikacionet duhet të dorëzohen në afatin kohor (deri 14 mars 2014) duke përdorur formularin e aplikimit të përpiluar veçanërisht për këtë fond. Aplikacionet duhet të ndjekin kriteret e përcaktuara në paketën e aplikimit dhe duhet të jenë brenda kompetencave vetanake të komunave siç përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë.

### **Kostot e pranueshme**

Kosto e pranueshme e projektit duhet të përfshinë kosto esenciale për sigurimin e realizimit të suksesshëm të projektit.

## **Kostot e papranueshme**

Të gjitha shpenzimet për zhvillimin dhe menaxhimin e projektit sa i përket burimeve njerëzore nuk do të kompensohen për realizimin e projektit.

## **Roli i AZHR-ve**

Komunat duhet të ftojnë AZHR-të ku ato bëjnë pjesë, për të ndihmuar zhvillimin dhe përgatitjen e projekteve të pranueshme në bazë të strategjive lokale dhe rajonale për zhvillim ekonomik. AZHR mund të ndihmojnë komunat, duke i dhënë këshilla lidhur me atë se çka e bene një projekt të mirë. AZHR nuk do të përfshihen në përzgjedhjen e projekteve. AZHR do të jenë në dispozicion për të ofruar këshilla për komunat gjatë zbatimit të projektit.

## **Procedura e implementimit**

Zhvillimi dhe miratimi i marrëveshje të mirëkuptimit (MM).Komunat të cilat i dorëzojnë aplikacionet e suksesshme, do të informohen nga MAPL-ja sa më shpejt të jetë e mundur pas përfundimit të procesit të vlerësimit. MM do të përgatitet nga MAPL-ja dhe do të diskutohet me komunat. Pasi të jenë pajtuar të dy palët mund të nënshkruhen MM, MAPL në bashkëpunim komunat do të fillojnë me procedurat e mëtejme për implementim te projektit sipas MM.

## **Procedurat e prokurimit**

Bartësit e procedurave të prokurimit do të jetë MAPL përveç nëse ndryshe specifikohet me marrëveshje të mirëkuptimit në mes palëve nënshkruese. Procedurat e prokurimit duhet ti referohen ligjit te prokurimit publik të Kosovës (LPPK)

## **Themelimi i një sistemi mbështetës për projektet**

MAPL-ja pret që fondi për ZHR, të jetë një program i suksesshëm i cili ka për qëllim të ofroj mbështetje për komunat. Qëllimi është për të ngritur kapacitetet brenda komunave për menaxhimin e projekteve në të ardhmen. Gjatë fazës së përgatitjes së MM, MAPL/DBZHR cakton një person kontaktues me komunat.

## **Monitorimi dhe Raportimi**

MAPL-ja do të monitoroj projektet dhe do të kontribuoj në ngritjen e kapaciteteve brenda komunës. Një zyrtar nga MAPL do të caktohet si përgjegjës për

bashkëpunim në mes të komunës dhe MAPL-së. Ky zyrtar do të monitoroj projektin gjatë gjithë fazave të implementimit. Komunitat obligohen të raportojnë mbi progresin e projektit për MAPL-në si dhe një raport final në fund të projektit.

### **Pagesat e vazhdueshme për kontraktorët**

Kontraktuesit do të përgatitin dhe paraqesin faturat e tyre në MAPL/Komuna, me të cilët ata kanë kontratë. Ata duhet të përpunojnë pagesën dhe pasi të vërtetojnë se të gjitha procedurat e rregullta janë përfillur, t'i bëjnë drejtpërdrejt pagesën kontraktorit bazuar në Ligjin e menaxhimit të financave publike në Kosovë. MAPL do të verifikon të gjitha pozicionet -punimet e kryera në terren para se të bëhet pagesa.

### **Pranimi i raporteve dhe faturës finale**

Është e rëndësishme që raporti përfundimtar të jetë gjithëpërfshirës dhe të përcakton se sa projekti ka arritur rezultatet e kërkuara nga aplikimi fillestar, bazuar në MM dhe kontratë. Fatura përfundimtare duhet të dorëzohet me raportin përfundimtar, deri më 30 nëntor 2014.

Afati (orari) për Fondet;

| Muaji               | Aktiviteti   |
|---------------------|--|
| Shkurt 2014         | Lansimi i Fondit të MAPL-së për Zhvillim Ekonomik Rajonal  |
| shkurt - mars 2014  | Komunitat përgatisin projektet dhe i dorëzojnë deri më 14 mars 2014  |
| mars/2014           | MAPL-ja kryen vlerësimin e projekteve<br>MAPL-ja merr vendim për kërkesat e suksesshme dhe fillon me përgatitjen e Marrëveshjet të Mirëkuptimit          |
| Fundi i Marsit 2014 | Marrëveshjet e Mirëkuptimit nënshkruhen nga palët e përcaktuara në MiM<br>Zotimi i fondeve sipas projekteve<br>Fillojnë procedurat e prokurimit sipas MM |

|                        |   |
|------------------------|---|
| Mars-Prill             | Përgatitja e dokumentacionit dhe shpallja e tenderit  |
| Prill - Maj            | Vlerësimi i tenderëve dhe përgatitja e kontratave.<br>Nënshkrimi i kontratave - fillimi i punimeve<br>Raportimi<br>Monitorimi |
| Qershor<br>deri Nëntor | MAPL-ja monitoron projektet<br>Raporti mujor i progresit bërë nga komunat ose MAPL i përcaktuar nga MM                        |
| Nëntor                 | Faturat finale dhe raportet e marra si dhe shqyrtimi i tyre nga MAPL-ja ( deri 30 nëntori 2014)                               |
| Dhjetor                | Pranimi i lendeve për pagese nga komunat deri me 12.12.2014   |
| Janar 2015             | Raporti final   |